



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALLAKASTËR  
NJËSIA E PROKURIMIT**

*Ballsh, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2025*

**PROCESVERBAL**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

*Objekti i prokurimit:*

**“Blerje ushqime dhe fruta perime për kopshtin dhe çerdhen**

*Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV):*

15111200-1 - Mish viçi, 15131500-0 - Produkte të pulave, 15511000-3 - Qumësht, 15540000-5 - Produkte të djathit, 15542100-0 - Gjizë, 03142500-3 - Vezë, 15551300-8 - Kos, 15884000-8 - Ushqim për fëmijë,

*Vlera e fondit limit:*

**3.964.111** (tremilion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e katërmijë e njëqind e njëmbdhjetë) **lekë pa TVSH.**

Bazuar në nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kjo procedurë prokurimi zhvillohet nga AK Bashkia Mallakastër, për nevojat e saj.

Për fillimin e kësaj procedure, nga Titullari i Autoritetit Kontraktor ka dalë urdhërin përkatës të prokurimit, nëpërmjet të cilit është ngritur edhe Njësia e Prokurimit. Në vijim, është marrë konfirmimi përkatës nga Dega e Thesarit Mallakastër, si dhe nga Sekori i Financës në Bashki është marrë numri i transaksionit të kërkesës (urdhërit të prokurimit) të regjistruar dhe aprovuar paraprakisht në sistemin SIMF dhe SIFQ, sipas njoftimit të përbashkët të MFE dhe APP dhe Manualit Teknik “Integrimi i Sistemit të Prokurimit Elektronik me AFMIS”.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor (OQB) Bashkia Mallakastër ka hartuar procesverbalin

për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

***Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenet 26, 29 dhe 30, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 82 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenet 26 dhe 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

#### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vertetim për xhiron vjetore të tre viteve të fundit financiare (2021, 2022, 2023), lëshuar nga Administrata Tatimore, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

***Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe në pikën 1, 2 dhe 3, të nenit 43, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e marzhit të xhiros së kërkuar në kufirin e përcaktuar më sipër, konsiderohet tregues i rëndësishëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes së kapaciteteve ekonomike dhe financiare të Operatorëve Ekonomikë ofertues, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

*Përveç bazës ligjore të sipërcituar, ky kriter është në përputhje edhe me legjislacionin e fushës, konkretisht, me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe në kërkesat e Ligjit Nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29, të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, përcaktohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.*

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim/e për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2024 sipas afateve të maturuara/përcaktuara dhe parashikuara në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar prej njësisë të vetëqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron dhe ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin/et e lëshuar nga njësia/të e vetëqeverisjes vendore përkatëse.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

**Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1/a dhe 2, e Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

*Përveç bazës ligjore të sipërcituar, ky kriter mbështetet edhe në legjislacionin e fushës, konkretisht, në përcaktimet e bëra në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, dhe në nenet 2, 4 dhe 40, të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar. Nëpërmjet këtij kriteri synohet të vërtetohet që Operatori Ekonomik ofertues, e ushtron aktivitetin e tij në përputhje me kuadrin rregullator dhe duke përmbushur në mënyrë korrekte detyrimet që burojnë sipas legjislacionit të fushës, pasi të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitet tregtar kanë detyrim të regjistrohen pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, për të bërë të identifikueshme vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshkruar pagesës së taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga ky legjislacion.*

### 2.3 Kapaciteti teknik :

**Lidhur me kapacitetet/aftësinë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:**

**2.3.1.** Për të provuar përvojën e mëparshme të suksesshme, kërkohen dëshmi për mallra të mëparshme, të ngjashme, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

**2.3.2** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej **minimalisht 3 persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit dhe shpërndarjes së mallrave në kopshtin dhe cerdhen.

**Argumentimi :** Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Autoriteti Kontraktor është në të drejtën e tij të bazuar në legjislacionin e

prokurimit publik dhe akteve nënligjorë të nxjerra në zbatim të tij, për të kërkuar deklarata për përmbushjen me sukses të kontratave.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë raport-analiza origjinale ose kopje të noterizuar të lëshuar nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i references për artikujt që prokurohen.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 6, gërma c,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe bazuar në Rekomandimin e përbashkët të datës 19.11.2018 të Agjencisë së Prokurimeve Publike dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

**2.3.5** Operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës ka detyrim të paraqesë dokumentacionin provues ku të provohet se nga kontrolli i fundit i AKU – së të lëshuar jo më parë se 30 (tridhjetë) ditë nga hapja e ofertave, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

**Argumentimi:** Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe pika 8, neni 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe bazuar në Rekomandimin e përbashkët të APP-së dhe AKU-së nr.10181 prot, datë 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”.

Paraqitja e dokumentacionit provues është kërkuar për të vërtetuar se operatori ekonomik ushtron aktivitet të rregullt në përputhje me legjislacionin në fuqi për fushën e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit. Ky kriter është vendosur me qëllim që të shërbejë AK për të siguruar cilësinë e ushqimit për kopshtin dhe cerdhen.

**2.3.6** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokument për pronësi ose përdorim kundrejt kontratave përkatëse të noterizuara, Njësi tregtare ushqimore / fruta perime ose ambiente për magazinimin e artikujve të tjere ushqimore. Ambjentet duhet të plotësojnë kushtet higjieno-sanitare dhe të jenë të pajisur me çertifikate pronësie ose përdorim (origjinal ose kopje e noterizuar) dhe leje higjieno-sanitare të lëshuar nga inspektorati shëndetsor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në pikën 5 /ç të nenit 40 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe bazuar në Rekomandimin e përbashkët të APP-së dhe AKU-së nr.10181 prot, datë 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”.

Me anë të këtij kriteri AK kërkon që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike (ambjente të përshtatshme për ruajtjen e frutave dhe perimeve) për të përmbushur me sukses kontratën, nisur edhe nga natyra e produkteve të bulmetit të cilat duhet të ruhen në kushte të përshtatshme higjeno-sanitare dhe teknologjike, me qëllim që të garantojnë sigurinë e frutave dhe perimeve.

**2.3.7** Ofertuesi duhet të ketë në pronësi ose në përdorim kundrejt kontratës përkatëse të noterizuar, mjete transporti të vlefshme për gjithë periudhën e zbatimit të kontratës për furnizimin e ushqimeve blegtorale, si me poshtë :

- Automjetet të përshtatshëm (frigoriferik ATV) për artikujt bulmet dhe mish (1 copë). Për automjetet të paraqiten certifikatat e pronësisë , kontratat e dhurimit apo të qirasë sipas rastit shoqëruar me certifikatën e pronësisë së qeradhënësit , si dhe dokumentacionin përkatës certifikatat e kontrollit teknik, lejet e qarkullimit , Siguracion të automjeteve në dispozicion, taksa e mjetit si dhe leje për transport mallrash si dhe leja higjeno-sanitare e mjetit. (dokumentacioni i kërkuar të jetë i vlefshëm në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi) .
- Operatori ekonomik duhet të disponojë automjetet të përshtatshëm ATP (1 copë). Për automjetet të paraqiten certifikatat e pronësisë , kontratat e dhurimit apo të qirasë sipas rastit shoqëruar me certifikatën e pronësisë së qeradhënësit , si dhe dokumentacionin përkatës certifikatat e kontrollit teknik, lejet e qarkullimit , Siguracion të automjeteve në dispozicion, taksa e mjetit si dhe leje për transport mallrash si dhe leja higjeno-sanitare e mjetit. (dokumentacioni i kërkuar të jetë i vlefshëm në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi) .

**Argumentimi :** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në piken 5 /ç të nenit 40 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe bazuar në Rekomandimin e përbashkët të APP-se dhe AKU-se nr.10181 prot, datë 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”.

Me anë të këtij kriteri AK kërkon që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike (Automjetet të përshtatshëm (frigoriferik ATV për artikujt bulmet dhe mish dhe automjetet të përshtatshëm ATP) për të përmbushur me sukses kontratën, nisur edhe nga natyra e produkteve (të mishit, bulmetit dhe të frutave, perimeve) të cilat duhet të ruhen në kushte të përshtatshme higjeno-sanitare, me qëllim që të garantojnë sigurinë e tyre. Operatori ekonomik fitues do të kryejë transportin e produkteve (deri në magazinën e AK dhe njëkohësisht të garantojë ruajtjen e vlerave ushqimore të këtyre produkteve.

**2.3.8** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë certifikata cilësie në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i

vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Certifikata e kërkuar është si më poshtë:

- ISO 9001:2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalente.
- ISO 22000:2018 (Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore) ose ekuivalente.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, pika 1 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar në piken 1, të nenit 44, të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe bazuar në Rekomandimin e përbashkët të APP-se dhe AKU-se nr.10181 prot, date 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”.

Kjo kërkesë dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë, sigurisë ushqimore.

**2.3.9** Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë Liçencë, kategoria II.1.A.1 “Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar në nenit 40, pika 5 , gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; Ky kriter është vendosur bazuar në pikën III të Rekomandimit nr. 10181 prot., datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore” të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

**\*\*\***

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike janë përgatitur nga struktura përkatëse duke iu referuar nenit 36 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Hartimi i specifikimeve teknike është kryer duke iu referuar kërkesave dhe nevojave për ushqime dhe fruta perime që kanë kopshti dhe cerdhjar.

Specifikimet teknike për shërbimet e kërkuara përshkruajnë tërësinë e elementëve më të rëndësishëm përbërës, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme në përputhje me parashikimet e ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (neni 36), dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (neni 40).

**Specifikimet teknike janë lehtësisht të aksesueshme dhe gjenden bashkëngjitur DST në skedarët e sistemit të prokurimit elektronik.**

**Shënim:** Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve

që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

***Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të kontratës në lidhje me mallrat :***

- **Produktet duhet të jenë të ambalazhuara me etiketë, ku të jenë specifikuar përbërësit dhe data e skadencës e largët.**
- **Të gjitha produktet të jenë të përshtatëshme sipas kërkesave të AK në cilësi, në të kundërt nuk do të merren në dorëzim.**
- **Produktet duhet të jenë të freskta dhe sipas standarteve bazuar në urdhrin e Ministrisë së bujqësisë.**
- **Artikujt e produkteve shtazore duhet të jenë brenda standarteve dhe të jenë të pajisur me vulën e veterinerit.**
- **Artikujt fruta-perime të jenë të cilësisë së parë,të jenë të freskta, jo të vyshkura dhe tu përgjigjen standarteve për shitje.**
- **OE të kryej furnizimin dhe të marrë përsiper me mjetin e tij transportin e mallit në adresën e AK.**
- **Transporti të bëhet me mjete të pastra ,të mbrojtura nga dëmtimet e faktorë të tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.**
- **Operatori Ekonomik duhet të ruaj vlerën e fondit limit me të cilin është shpallur fitues ,pavarsisht ndryshimit të cmimeve në periudha sezonale. Ndryshimi i cmimit duhet të jetë i justifikuar nga OE**

***Afati i Ekzekutimit:*** 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Lëvrimi do të jetë periodik, i përditshëm sipas kërkesave të AK,Bashkia Mallakastër. Malli do të lëvrohet çdo ditë të javës nga e Hëna në të Premte.

Sasia e mallit që do të lëvrohet, do të kërkohet nga Autoriteti Kontraktor çdo ditë, në bazë të përlllogaritjeve ditore, duke iu referuar frekuentimit ditor, menjëherë ushqimore të çerdhës dhe kopshtit, sipas normativave të miratuara.

**Kushtet e lëvrimit:**

- Mallrat do të lëvrohen me automjetin e Subjektit Kontraktor në magazinën e Autoritetit Kontraktor.
- Furnizimi do të kryhet çdo ditë duke filluar prej orës 07:00 deri në orën 09:00.

**NJËSIA E PROKURIMIT**